



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.Shk II.nr. 1383/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbartimore të kreditorit HIB Petrol Sh.p.k, me nr. unik identifikues 810662834, me seli në Magjistralen Prishtinë-Ferizaj, Talinoc i Muhaxherëve, i cili sipas autorizimit përfaqësohet nga E.A., kundër debitorit Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me seli në Prishtinë, rr. “UÇK, nr.1, e cila përfaqësohet nga Avokatura Shtetërore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.751/22 të datës 19.09.2023, me datë 18.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e Debitorit Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr. 751/22 të datës 19.09.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.751/22 të datës 19.09.2023, në pikën e I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ashtu që ka anuluar pjesërisht Urdhrin Përmbartimor P.nr.944/21 i datës 28.05.2021, nga Përmbartuesi Privat Valdrin Beka, për pjesën e detyrimit në shumën prej 9,839.35 EUR. Ndërsa, në pikën II të dispozitivit ka refuzuar pjesërisht si të pabazuar prapësimin e debitorit Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për pjesën e detyrimit në lartësi prej 644.70 EUR, dhe në këtë pjesë ka lënë në fuqi Urdhrin përmbartimor P.nr. 944/21, i lejuar me datë 28.05.2021, nga Përmbartuesi Privat Valdrin Beka.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës përmbare, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale-Dhomës së Shkallës së Parë, KPPP.nr. 751/22 të datës 19.09.2023.

Kreditori ka ushtruar përgjigje në ankesë nëpërmjet të cilës ka theksuar se pretendimet e debitorit janë qartazi të pa bazuara dhe të pambështetura me prova dhe me fakte. Andaj ka kërkuar nga Gjykata e Shkallës së Dytë, që të refuzoj në tërësi ankesën e debitorit dhe të vërtetoj aktvendimin e Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 751/22 të datës 19.09.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbare si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori HIB Petrol Sh.p.k., dt. 28.05.2021, ka paraqitur propozim për përmbare mbi bazën e dokumenteve të besueshme - Faturë nr. FDT17-8-005549 e datës 30.11.2017; faturë nr. FDT17-8-005895 e datës 31.12.2017; faturë nr. FDT18-8-000293 e datës 31.01.2018; faturë nr. FDT18-8-003151 e datës 31.07.2018; faturë nr. FDT18-8-003591 e datës 31.08.2018; faturë nr. FDT18-8-004218 e datës 30.09.2018; faturë nr. FDT18-8-004219 e datës 30.09.2018; faturë nr. FDT18-8-004224 e datës 30.09.2018; faturë nr. FDT18-8-004226 e datës 30.09.2018; faturë nr. FDT18-8-004804 e datës 31.10.2018; faturë nr. FDT18-8-005323 e datës 30.11.2018; faturë nr. FDT18-8-005333 e datës 30.11.2018; faturë nr. FDT19-8-001311 e datës 28.02.2019; faturë nr. FDT19-8-001303 e datës 28.02.2019; faturë nr. FDT19-8-001300 e datës 28.02.2019; faturë nr. FDT19-8-003355 e datës 30.06.2019; 17. faturë nr. FDT19-8-003357 e datës 30.06.2019; dhe faturë nr. FDT19- 8-003358 e datës 30.06.2019, ka lejuar Urdhrin Përmbare P.nr. 944/21, të datës 28.05.2021, duke urdhëruar debitorin që në emër të borxhit për furnizim me derivate të naftës, t'ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 10,484.05 EUR (dhjetëmijë e

katërqind e tetëdhjetë e katër euro, e zero pesë euro cent) nga dita e arritjes për pagesë si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore për aq sa do të krijohen në këtë procedurë përbarimore.

Përbaruesi Privat Valdrin Beka, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit përpërbarim të kreditorit me urdhrin përbarimor P.nr. 944/21 të datës 28.08.2021, e ka lejuar përbarimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori ka ushtruar prapësim duke kundërshtuar Urdhrin për lejimin e përbarimit, me arsyetimin se debitori ka përmbushur faturat nr. FDT17-8-005895 e datës 31.12.2017; nr. FDT18-8-000293 e datës 31.01.2018; nr. FDT18-8-004219 e datës 30.09.2018; nr. FDT18-8-004224 e datës 30.09.2018; nr. FDT18-8-004804 e datës 31.10.2018; nr. FDT18-8-005323 e datës 30.11.2018 dhe faturën nr. FDT18-8-005333 e datës 30.11.2018, ndërsa për faturat tjera kreditori ka deklaruar se do të barazohet me debitorin, ndërsa Kreditori, me datë 22.06.2021 ka paraqitur parashtresë për precizimin e borxhit pranë përbaruesit Privat duke pohuar faktin se debitori ka përmbushur shtatëmbëdhjetë (17) nga gjithsej tetëmbëdhjetë (18) faturat mbi bazën e të cilave është lejuar përbarimi, ashtu që ka kërkuar nga Gjykata që urdhri përbarimor të ngelet në fuqi vetëm sa i përket shumës prej 644.70 EUR, që ka të bëjë me faturën nr. FDT18-8-004224 e datës 30.09.2018.

Me qëllim të shqyrtimit të validitetit të prapësimit të debitorit, Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, në kuptim të nenit 73, par.1 të LPP-së ka caktuar seancën dëgjimore lidhur me këtë çështje përbarimore me datë 07.09.2023. Debitori, përgjatë seancës dëgjimore ka qëndruar pranë deklarimeve të dhëna në prapësim, duke shtuar se debitori i ka paguar të gjitha faturat objekt i këtij përbarimi, dhe se ka kontaktuar me kreditorin duke i kërkuar që të shkojë në zyre të Ministrisë – Departamenti i Financave, me qëllim që t'i shqyrtoj faturat një nga një. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të shfuqizohet Urdhri Përbarimor P.nr. 944/21 i datës 28.05.2021. Kreditori, në seancën dëgjimore ka qëndruar pranë parashtresës për precizimin e borxhit e datës 22.06.2021, duke theksuar se debitori ka mbetur në borxh tek kreditori vetëm sa i përket faturës nr. FDT18-8-004224 e datës 30.09.2018 të cilën ende nuk e ka paguar. Me kërkesë që urdhri për lejimin e përbarimit të mbetet në fuqi në shumën prej 644.70 EUR

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.751/22 të datës 19.09.2023, në pikën e I të dispozitivit ka

aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ashtu që ka anuluar pjesërisht Urdhrin Përmbarimor P.nr.944/21 i datës 28.05.2021, nga Përmbaruesi Privat Valdrin Beka, për pjesën e detyrimit në shumën prej 9,839.35 EUR. Ndërsa, në pikën II të dispozitivit ka refuzuar pjesërisht si të pabazuar prapësimin e debitorit Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për pjesën e detyrimit në lartësi prej 644.70 EUR, dhe në këtë pjesë ka lënë në fuqi Urdhrin përmbarimor P.nr. 944/21, i lejuar me datë 28.05.2021, nga Përmbaruesi Privat Valdrin Beka.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka vlerësuar se Urdhri Përmbarimor P.nr. 944/21, i lejuar me datë 28.05.2021 gjeti se në mes kreditorit dhe debitorit nuk është kontestues fakti se debitori ka përmbushur shtatëmbëdhjetë (17) nga gjithsej tetëmbëdhjetë (18) faturat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi, e të cilat fatura arrijnë vlerën prej 9,839,35 EUR, fakt ky që pohohet nga vet kreditori me rastin e paraqitjes së së parashtrësës për precizimin e borxhit të datës 22.06.2021.

Tutje gjykata e Shkallës së parë ka vendos si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktvendimi, duke lënë në fuqi urdhrin për lejimin e përmbarimit në vlerë prej 644.70 EUR, pasi që fatura nr. FDT18-8-004224 e datës 30.09.2018 prej të cilës buron ky borxh është e përshtatshme për përmbarim, pasi që fatura në fjalë i plotëson të gjitha elementet e parapara me nenin 29.3 të LPP-së, ashtu që në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara qartë shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi dhe faturat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt përmes nënshkrimit të tyre.

Po ashtu gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar edhe pretendimet e debitorit, si në prapësim, ashtu edhe përgjatë seancës dëgjimore, përkundër se ka pretenduar përmbushjen e borxhit edhe sipas kësaj fature, i njëjti nuk ka sjellë asnjë provë nga e cila vërtetohet se është paguar borxhi sipas kësaj fature, pasi që secila nga dëshmitë e pagesave të bashkangjitura nga debitori në prapësim, iu referohen pagesës së faturave tjera dhe jo faturës nr. FDT18-8-004224 të datës 30.09.2018.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur në pikën I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke shfuqizuar urdhrin

përbarimor për pjesën e borxhit prej 9,839.35€, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikim nga shkresat e lëndës konstatohet se debitori ka përmbushur shtatëmbëdhjetë (17) nga gjithsej tetëmbëdhjetë (18) faturat mbi bazën e të cilave është lejuar përbarimi, e të cilat fatura arrijnë vlerën prej 9,839,35 EUR, fakt ky që pohohet nga vet kreditori me rastin e paraqitjes së parashtrësës për precizimin e borxhit të datës 22.06.2021, Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 71 par.1 nën par.1.2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se prapësimi mund të bazohet vetëm nëse: “dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përbarues ose urdhri përbarues është prishur, anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik” vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi duke aprovuar prapësimin e debitorit për shkak të pagesës së borxhit ndaj kreditorit, andaj për këtë arsye vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, sa i përket pikës II të dispozitivit vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përbarimore kur ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit, duke lënë në fuqi urdhrin për lejimin e përbarimit në vlerë prej 644.70 EUR, pasi që fatura nr. FDT18-8-004224 e datës 30.09.2018 prej të cilës buron ky borxh është e përshtatshme për përbarim, pasi që fatura në fjalë i plotëson të gjitha elementet e parapara me nenin 29.3 të LPP-së, ashtu që në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara qartë shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi dhe faturat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt përmes nënshkrimit të tyre.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve të kësaj gjykate rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Kjo gjykatë vlerësoj edhe pretendimet ankimore lidhur me atë se fatura në fjalë nuk është në origjinalë por të njejtën e refuzoj si të pa bazuar për faktin se fatura nr. FDT18-8-004224 e datës 30.09.2018 është e vërtetuar tek noteri Selatin Shahini. Po ashtu gjykata vlerësoi edhe pretendimet

tjera ankimore të debitorit duke theksuar se gjykata nuk i ka marrë për baze deklarinmet nga seanca dëgjimore dhe prapësimin e datës 03.06.2021, ku janë dëshmuara faturat dhe pagesat e debitorit i cili ka përmbushur obligimin financiar që ka pasur ndaj kreditorit sipas faturave, mirëpo për këtë gjykatë të njëjtat mbesin të pabazuara pasi që me shikim në shkresat e lëndës kjo gjykatë vlerëson se debitori në ankesë nuk ka arrit ti argumentoj e as nuk ka bashkangjitur ndonjë prove juridikisht të vlefshme ashtu siç kërkon neni 69.4 i LPP dhe si të tilla i refuzoj ndërsa aktvendimin e ankimuar e vërtetoj.

Përndryshe në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kompetenca e Dhomës se Shkalles se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.1383/23 me datë 18.03.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija Ymeri